



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 janar 2020
Nr. ref.:RK 1501/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI180/18

Parashtrues

Metullahe Hoxha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme
Rev. nr. 144/2018, të 4 majit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Metullahe Hoxha, me vendbanim në lagjen Bregu i Diellit, p.n., Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga Ali Latifi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev. nr. 144/2018] e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të 4 majit 2018.
3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 13 qershor 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkëlur të drejtat e garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 57 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 nëntor 2018, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 29 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 14 nëntor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 14 nëntor 2019, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojë kopjen e vërtetimit kur parashtrueses së kërkesës i është dorëzuar Aktvendimi [Rev. nr. 144/2018] i Gjykatës Supreme, të 4 majit 2018. Në të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

10. Më 27 nëntor 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi në Gjykatë vërtetimin për dorëzimin e Aktvendimit [Rev. nr. 144/2018] të Gjykatës Supreme, parashtrueses së kërkesës, me datën e dorëzimit 13 qershor 2018.
11. Më 18 dhjetor 2019, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 5 korrik 2012, me Vendimin [Nr. 03 nr. 118-23644] e Drejtorisë për Arsim të Komunës së Prishtinës parashtrueses së kërkesës i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së kufirit të moshës prej 65 vjetësh më 13 qershor 2012. Kjo datë e përmendur në fund të fjalisë paraprake paraqet datën e pensionimit të parashtrueses së kërkesës.
13. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës kërkoi nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Prishtinës t'ia paguajë tri paga mujore në emër të pagesës për përcjellje në pension, dy paga mujore si shpërblim jubilar si dhe regresin për pushimin vjetor. Kjo kërkesë e parashtrueses u refuzua *“për shkak të mungesës së një dispozite ligjore për zbatimin e marrëveshjes kolektive nga ana e Qeverisë së Kosovës”*.
14. Më 27 korrik 2012, parashtruesja e kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), ku pretendonte se gjatë marrjes së vendimit për pensionimin, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës nuk i ka respektuar dispozitat e neneve 42, 43 dhe 44 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive dhe se në këtë mënyrë, sipas pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, ajo ishte dëmtuar për tri paga mujore në emër të pagesës për përcjellje në pension, dy paga mujore si shpërblim jubilar dhe regresin për pushimin vjetor, në shumë monetare prej 1921.50 €.
15. Më 31 mars 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C. nr. 2088/12] e miratoi padinë e parashtrueses së kërkesës dhe e obligoi Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Prishtinës t'ia paguajë parashtrueses së kërkesës dy paga mujore si shpërblim jubilar dhe dy paga në emër të pagesës për përcjellje në pension në shumë prej 1401 €, me një normë interesi prej 3.5%, e cila llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit deri në pagesën përfundimtare.
16. Në një datë të paspecifikuar, Drejtoria e Arsimit të Komunës së Prishtinës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë për shkak të *“aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozimin që ankesa të miratohet, ashtu që çështja t'i kthehet për shqyrtim të serishëm gjykatës së shkallës së parë, apo të ndryshohet në mënyrë që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazë”*.
17. Më 6 shtator 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AC. nr. 3789/2014] e miratoi, si të bazuar, ankesën e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës dhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke e refuzuar si të pabazë padinë e parashtrueses së kërkesës për të obliguar Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Prishtinës që t'ia paguajë parashtrueses së kërkesës në emër të

kompensimit dy paga mujore si shpërblim jubilar dhe dy paga në emër të pagesës për përcjellje në pension.

18. Parashtruesja e kërkesës parashtrroi kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të ligjit material.
19. Më 4 maj 2018, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 144/2018] e refuzoi si të palejuar kërkesën për revizion të parashtrueses së kërkesës për shkak se vlera e kontestit ishte nën kufirin ligjor mbi bazën e të cilit mund të shqyrtohen kërkesat për revizion.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesja e kërkesës pretendon se duke e refuzuar kërkesën e saj për revizion si të palejuar, Gjykata Supreme i shkelti të drejtat e saj të mbrojtura me nenet 3, 4, 21, 22, 23, 24, 31 dhe 57 të Kushtetutës, si dhe të drejtën e garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së.
21. Parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të neneve 3 dhe 4 të Kushtetutës që rezultoi për faktin se nuk trajtohen të gjithë në mënyrë të barabartë për shkak se, siç tha ajo: *“disa nga kolegët e mi kishin arritur të drejtën në pagën jubilarë me rastin e shkuarjes në pension, ndërsa unë kam vite që kërkoj një të drejtë të pakontestueshme”*.
22. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon edhe shkeljen e Kapitullit I dhe II, më konkretisht të neneve 21, 22, 23, 24, 31 dhe nenit 57 të Kushtetutës, që rezultoi nga fakti se Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës *“nuk ka aplikuar nenin 90 të Ligjit të Punës dhe të Kontratës Kolektive, dhe kështu ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Konventën Ndërkombëtare të vitit 1948, me Kushtetutën e Kosovës, Kapitujt I dhe II, si dhe Ligjin e Punës, Kontratën Kolektive të nënshkruar nga ana e Qeverisë së Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Oda Ekonomike, Sindikata Qendrore, të cilat i garantojnë të gjitha shërbimeve publike dhe private që, pas daljes në pension, do të paguajnë një pagë mujore për çdo 10 vjet dhe 2 paga mujore, për shkak të shkuarjes në pension”*.
23. Parashtruesja e kërkesës më tej pohon se në rastin e saj nuk janë zbatuar normat e Ligjit të Punës, Kontratës Kolektive dhe Konventës, të cilat janë të garantuara me Kushtetutën e Kosovës.
24. Sa i përket vendimmarrjes nga Gjykata Supreme, parashtruesja e kërkesës deklaroi se, *“Gjykata Supreme në Aktvendimin e saj e hedh poshtë revizionin si të palejuar duke u arsyetuar në nenin 215 të LPK por gjithashtu me nenin 211.3 të LPK, duke pretenduar se vlera e përgjithshme e objektit të kontestit nuk e kalon shumën prej 3,000 €, mirëpo gjykata nuk lëshohet fare në pikën 4 të nenit 211 pika c), e cila thotë: në kontestet nga marrëdhëniet e punës të cilat i fillon i punësuar kundër vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës, revizioni gjithmonë është i lejuar, me përjashtim të pikave të caktuara të nenit 211 të LPK-së”*.

25. Përfundimisht, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata: *“që ish mësueses t'i njihet e drejta në pagat përcjellëse që i takojnë, për çdo 10 vite, 1 pagë si dhe 3 pagat përcjellëse”*.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 113

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

29. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin Rev. nr. 144/2018 të e Gjykatës Supreme. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë për të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet e nenit 48 të Ligjit.

30. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

“[...]”

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit [...].“

31. Në këtë rast, Gjykata vëren se vendimi i kontestuar (Aktvendimi Rev. nr. 144/2018) i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 13 qershor 2018, ndërsa kërkesa kushtetuese është dorëzuar më 16 nëntor 2018.

32. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkesa kushtetuese është dorëzuar jashtë afatit ligjor 4 (katër) mujor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe specifikuar më tej me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së Punës.

33. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një kohe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t’u kontestuar (shih rastin *Sabri Güneş kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 39, dhe *mutatis mutandis*, shih rastin nr. KI140/13, parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 marsit 2014).

34. Bazuar në atë që u tha më lartë, kërkesa nuk është dorëzuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

35. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës është dorëzuar jashtë afatit dhe duhet të deklarohet e papranueshme, për shkak se nuk është dorëzuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 18 dhjetor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi